

URDHËR
Nr. 262, datë 11.11.2019

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 12, pika 1 dhe 13, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenit 7, pika 3, të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, në mungesë të kryetarit të Kolegjit,

URDHËROJ:

1. Delegimin e pjesshëm të kompetencave të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, gjyqtarit më të vjetër në moshë, z. Luan Daci, si vijon:

- a) përgatit, thërret e drejton mbledhjen e anëtarëve;
- b) përfaqëson Kolegjin e Posaçëm të Apelit në marrëdhënie me të tretët;
- c) ndërmerr të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për të siguruar funksionimin efektiv dhe efikas të Kolegjit;
- d) nënshkruan aktet e tjera të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me përjashtim të vendimeve;
- e) drejton shortin në rastet e përcaktuara në nenet 14, 15, 18, pika 4, të ligjit nr. 84/2016.

2. Delegimi i kompetencave të mësipërme është për periudhën 13 nëntor 2019, deri në 15 nëntor 2019.

3. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet gjyqtari më i vjetër në moshë, z. Luan Daci.

4. Z. Luan Daci nuk mund t’i nëndelegojë këto kompetenca.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Natasha Mulaj